

Autoriteti i Dosjeve sjell debatin shkencor mbi mekanizmat e kontrollit të ish-Sigurimit të Shtetit

Nga platformat sekrete te rrjeti i bashkëpunësorëve, burgjet dhe trauma ndërbreznore – Konferencën Ndërkombëtare Shkencore "Aspekte të përndjekjes politike të ish-Sigurimit të Shtetit Shqiptar (1944–1991)"

Tiranë, 29 qershor 2026- Si ndërtohej figura e "armikut"? Si funksiononte aparati i survejimit? Si prodhohej frika dhe kontrolli shoqëror? Dhe pse pasojat e këtij sistemi vazhdojnë të ndikojnë edhe sot?

Këto janë disa nga pyetjet që po marrin përgjigje në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore "Aspekte të përndjekjes politike të ish-Sigurimit të Shtetit Shqiptar (1944–1991)", organizuar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), e cila mbledhi në Tiranë studiues shqiptarë dhe të huaj për të prezantuar kërkime të reja të mbështetura në dokumente autentike arkivore.

Në hapje të konferencës, **Kryetarja e AIDSSH-së, Dr. Gentiana Sula**, theksoi se Shqipëria po hyn në një etapë të re të studimit të së kaluarës komuniste, ku dokumentet arkivore nuk shërbejnë vetëm për të rikthyer kujtesën historike, por për të ndërtuar dije shkencore dhe për ta vendosur rastin shqiptar në debatin europian mbi policinë sekrete dhe regjimet totalitare.

Dokumentet zbulojnë mekanizmat e fshehtë të aparatit represiv

Punimet e ditës së parë sollën një sërë gjetjesh të reja mbi mënyrën se si funksiononte Sigurimi i Shtetit.

Evolucioni i Sigurimit të Shtetit pasqyron mënyrën se si u zgjerua aparati i represionit komunist

Një studim i prezantuar nga **Altin Hoxha**, anëtar i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me **Elona Baçin, Irma Batajn, Endrit Tolin dhe Mirvjena Imamin**, rindërton për herë të parë në mënyrë të plotë evolucionin strukturor të Sigurimit të Shtetit, nga krijimi i tij më 14 dhjetor 1944 deri në shpërbërjen në korrik 1991.

Studimi tregon se, ndonëse **de jure** Sigurimi u krijua si shërbim për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, **de facto** ai u shndërrua në instrumentin kryesor të shtypjes së kundërshtarëve politikë dhe të garantimit të mbijetesës së regjimit komunist.

Sipas autorëve, ndryshimet organizative dhe strukturore të Sigurimit gjatë afro pesë dekadave nuk ishin thjesht reforma institucionale, por pasqyronin fazat e ndryshme të terrorit politik, represionit dhe konsolidimit të pushtetit. Analiza eidenton se zgjerimi dhe transformimi i strukturave të tij shoqëroi evolucionin e mekanizmave të kontrollit mbi shoqërinë shqiptare.

Studimi ofron një kuadër të plotë historik dhe institucional për të kuptuar organizimin e aparatit të Sigurimit të Shtetit dhe krijon një bazë të rëndësishme kërkimore për studimet mbi funksionimin e sistemit totalitar dhe mekanizmat e përndjekjes politike në Shqipëri.

Kryetarët e degëve të Sigurimit ishin hallka kyçe e aparatit represiv në rrethe

Një studim i prezantuar nga **Gjergj Marku**, anëtar i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me **Marvina Shtyllën, Gerald Vjollcën, Eglantina Daullen dhe Elibjana Buçpapajn**, hedh dritë mbi rolin e kryetarëve të degëve të Sigurimit të Shtetit si zbatuesit kryesorë të politikave represive në nivel lokal.

I mbështetur në dokumente origjinale arkivore, studimi evidenton se kryetarët e degëve nuk kishin vetëm detyrën të zbatonin urdhrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, por ushtronin një rol vendimmarrës në administrimin e përndjekjes politike në rrethe. Ata hartonin raporte sekrete, drejtonin veprimtarinë operative, mbikëqyrnin ndjekjen e kundërshtarëve politikë dhe mbanin përgjegjësi për zbatimin e internimeve, burgosjeve, konfiskimeve të pronave dhe masave të tjera represive.

Sipas studimit, analiza e dokumenteve synon të zbërthejë hierarkinë e funksionimit të Sigurimit në nivel vendor dhe të evidentojë se si vendimmarrja e drejtuesve lokalë ndikonte drejtpërdrejt në fatin e mijëra të përndjekurve politikë. Hulumtimi ngre gjithashtu pyetjen nëse, në raste të caktuara, këta drejtues tejkalonin urdhrat e marrë nga qendra, duke ushtruar një rol edhe më të gjerë në mekanizmin e represionit.

Studimi ofron një panoramë të re mbi funksionimin e aparatit të Sigurimit në rrethe dhe kontributin e strukturave lokale në zbatimin e politikave të kontrollit dhe të përndjekjes gjatë regjimit komunist.

Platformat e sigurimit jashtë bazës ligjore

Në sesionin kushtuar aspekteve operative dhe metodave të punës së Sigurimit të Shtetit, ekspertja ligjore e AIDSSH-së, Liljana Çoçoli, prezantoi studimin "Platformat e punës operative dhe baza ligjore e Sigurimit të Shtetit", të realizuar nga grupi i punës i drejtuar nga Prof. Asoc. Dr. Albert Nikolla, anëtar i Autoritetit, në bashkëpunim me Adela Toporjen, Jonel Hibon, Liljana Çoçolin dhe Mirela Lamën (AIDSSH).

Studimi argumenton se veprimtaria operative e Sigurimit të Shtetit nuk mbështetej në ligje të miratuara nga organet shtetërore, por në platforma të brendshme sekrete, të cilat nuk morën kurrë statusin e dokumenteve zyrtare të shtetit.

Sipas autorëve, pikërisht këto platforma përcaktonin organizimin e rrjetit agjenturor, procedurat e rekrutimit, klasifikimit, drejtimit dhe mbikëqyrjes së bashkëpunëtorëve, duke krijuar një mekanizëm paralel kontrolli jashtë bazës ligjore.

Studimi evidenton se kjo praktikë e vendoste veprimtarinë e Sigurimit të Shtetit në kundërshtim me Kushtetutën dhe legjislacionin shqiptar të periudhës 1944–1990. Një tjetër përfundim i rëndësishëm është se rekrutimi i bashkëpunëtorëve nuk mbështetej vetëm në bindje ideologjike,

por edhe në shtrëngim, manipulim dhe presion psikologjik, duke e shndërruar rrjetin agjenturor në një mekanizëm të organizuar kontrolli, frikësimi dhe nënshtrimi të shoqërisë.

Kontrasti mes retorikës për Kosovën dhe praktikës së survejimit

Ndërsa regjimi komunist e paraqiste bashkëpunimin me Kosovën si pjesë të unitetit kombëtar, dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit tregojnë një realitet krejt tjetër.

Ky është përfundimi i studimit të paraqitur nga **Prof. Dr. Arbër Hadri, Sekretar Shkencor i Institutit të Historisë "Ali Hadri"**, i cili analizozi mënyrën se si Sigurimi i Shtetit i trajtonte qytetarët nga Kosova, diasporën shqiptare dhe vizitorët nga hapësirat shqiptare jashtë kufijve gjatë periudhës 1945–1991.

Sipas dokumenteve arkivore të analizuara, ndërkohë që bashkëpunimi në arsim, shkencë dhe kulturë promovohet zyrtarisht si prioritet kombëtar, shumë kosovarë dhe shqiptarë nga jashtë vendit konsideroheshin nga Sigurimi si rrezik potencial. Ata vendoseshin nën survejim, përballëshin me internime, burgosje ose përpjekje për rekrutim si bashkëpunëtorë. Studimi arrin në përfundimin se logjika e kontrollit politik mbizotëroi mbi retorikën e solidaritetit kombëtar, duke nxjerrë në pah kontradiktën midis diskursit zyrtar të regjimit dhe praktikave të aparatit të Sigurimit.

Hetuesia dhe burgjet si instrumente të terrorit politik

Një studim i prezantuar nga **Skënder Vrioni**, në bashkëpunim me **Dr. Edlir Orhanin, Elisabeta Gripshin, Gerla Kotkën dhe Elton Kryemadhin**, argumenton se hetuesia e ish-Sigurimit të Shtetit nuk kishte vetëm funksionin e zbatimit të ligjit penal, por ishte një nga instrumentet kryesore të funksionimit të sistemit represiv komunist.

I mbështetur në dokumente arkivore, dosje procedurale, dëshmi të ish-të burgosurve politikë dhe analiza të burimeve historike, studimi evidenton se procesi hetimor përdorej për të prodhuar prova, dëshmi dhe rrëfime që legjitimonin ndëshkimin e kundërshtarëve politikë.

Sipas autorëve, përdorimi i dhunës fizike, manipulimi i dëshmimeve dhe terrori psikologjik nuk përbënin raste të izoluar, por pjesë të një mekanizmi të organizuar intimidimi, që synonte të siguronte nënshtrimin e individit dhe të mbështeste funksionimin e gjykatave, prokurorisë dhe gjithë aparatit represiv të regjimit.

Studimi arrin në përfundimin se hetuesia ishte një hallkë kyçe në ruajtjen e pushtetit totalitar, ndërsa pasojat e praktikave të saj shtrihen përtej proceseve gjyqësore, duke lënë gjurmë të thella në kujtesën dhe traumën kolektive të shoqërisë shqiptare.

Sigurimi i Shtetit kontrollonte çdo aspekt të jetës së të burgosurve politikë edhe pas dënimit

Një nga studimet e prezantuara në konferencë nga **PhD. Femi Sufaj** argumenton se burgjet dhe kampet e internimit gjatë regjimit komunist nuk ishin vetëm institucione për ekzekutimin e dënimeve, por pjesë përbërëse e mekanizmit të kontrollit politik të Sigurimit të Shtetit.

I mbështetur në dokumente arkivore, studimi evidenton se strukturat e Sigurimit, të vendosura brenda burgjeve dhe kampeve, funksiononin në mënyrë të pavarur nga administrata e këtyre institucioneve dhe ushtronin kontroll të drejtpërdrejtë mbi jetën e të burgosurve politikë. Çdo vendim që lidhej me lirimin me kusht, transferimin, regjimin e vuajtjes së dënimit, vizitat familjare, korrespondencën apo edhe lehtësitë më të vogla, varej nga miratimi me shkrim i punëtorit operativ të Sigurimit.

Studimi tregon se të burgosurit politikë vazhdonin të konsideroheshin "armiqtë e popullit" edhe gjatë vuajtjes së dënimit, duke mbetur objekt i survejimit, hetimit dhe ridënimit. Dokumentet arkivore dëshmojnë se Sigurimi organizonte një rrjet të gjerë kontrolli përmes bashkëpunëtorëve të infiltruar në burgje dhe kampe, të cilët përdoreshin për mbledhjen e informacionit, provokimin e incidenteve, nxitjen e përçarjeve dhe zbulimin e çdo forme rezistence ndaj regjimit.

Duke iu referuar raporteve të viteve 1959 dhe 1962, autori evidenton se administrata e Sigurimit i konsideronte burgjet objekte të një rëndësie të veçantë, ku çdo shfaqje pakënaqësie interpretohej si veprimtari armiqësor. Për këtë arsye, të burgosurit transferoheshin nga një burg në tjetrin për të penguar organizimin e tyre, ndërsa rrjeti i bashkëpunëtorëve përdorej për të mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm të dënuarit politikë.

Sipas autorit, dokumentet provojnë se sistemi i burgjeve nuk kishte si funksion rehabilitimin e individit, por vazhdimin e kontrollit politik edhe pas vendimit të gjykatës. Në këtë mënyrë, burgjet dhe kampet u shndërruan në një zgjatim të aparatit të Sigurimit të Shtetit, ku mbikëqyrja, hetimi, manipulimi dhe ndëshkimi vazhdonin deri në përfundim të dënimit, madje edhe pas lirimit të të burgosurve.

Sigurimi i Shtetit përdorte bashkëpunëtorë paralelë për të survejuar edhe rrjetin e vet informativ

Një tjetër risi ishte studimi i Prof. Asoc. Dr. Artan Puto, sipas të cilit Sigurimi përdorte mekanizmin e "bashkëpunëtorëve paralelë", ku informatorët kontrollonin edhe njëri-tjetrin, duke krijuar një sistem të shumëfishtë mbikëqyrjeje brenda vetë rrjetit informativ.

Prof. Asoc. Dr. Artan Puto, pedagog në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, zbulon se Sigurimi i Shtetit kishte ndërtuar një mekanizëm të kontrollit të ndërsjellë, ku bashkëpunëtorët nuk mbikëqyrnin vetëm objektivat e interesit, por edhe njëri-tjetrin.

Duke analizuar dosje model të bashkëpunëtorëve dhe të ashtuquajturve "**bashkëpunëtorë paralelë**", studimi tregon se ky sistem synonte të garantonte disiplinën, standardizimin dhe efikasitetin operacional të rrjetit informativ, duke e bërë kontrollin të vazhdueshëm edhe brenda vetë strukturës së Sigurimit.

Sipas autorit, evolucioni i praktikave operative gjatë viteve 1945–1991 dëshmon se mekanizmat e rekrutimit, organizimit dhe mbikëqyrjes u përshtatën vazhdimisht me zhvillimet politike të regjimit, ndërsa fenomeni i "bashkëpunëtorëve paralelë" përfaqëson një nga format më të sofistikuar të kontrollit të brendshëm të aparatit represiv.

Sigurimi shqiptar e çoi në ekstrem modelin represiv të vendeve komuniste

Në studimin e tij, **Dr. Ardian Elezi** argumentoi se, megjithëse Sigurimi i Shtetit u frymëzua nga modelet e shërbimeve sekrete të Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera të bllokut lindor, në Shqipëri metodat e tyre u zbatuan në forma edhe më të ashpra.

Sipas studimit, izolimi ekstrem, lufta e klasave dhe rrjeti i gjerë i survejimit e shndërruan Sigurimin në një instrument të kontrollit total, që mbikëqyrte jo vetëm shoqërinë, por edhe vetë strukturat e Partisë së Punës. Krahasimi me vendet e tjera ish-komuniste eidenton se modeli shqiptar u dallua për nivelin e lartë të represionit dhe të kontrollit mbi jetën e qytetarëve

Si ndërtohej rrjeti i bashkëpunëtorëve?

Një pjesë e rëndësishme e konferencës iu kushtua analizës së rrjetit të bashkëpunëtorëve. Studimet e **Selami Zallit, Mirela Murrizit, Oralda Muçës, Anxhela Dervishit, Miranda Imamit dhe Elona Baçit** sollën një panoramë të plotë mbi mënyrën se si Sigurimi përzgjidhte, rekrutonte, kontrollonte dhe mbante aktiv rrjetin informativ, duke dëshmuar se bashkëpunimi nuk ishte gjithmonë rezultat bindjeje ideologjike, por shpesh produkt i shtrëngimit, frikës dhe presionit psikologjik.

Tipologjia e bashkëpunëtorëve zyrtarë të Sigurimit të Shtetit: "Sherlokholmsët" si model operacional i aparatit represiv

Në kumtesën "Tipologjia e bashkëpunëtorëve zyrtarë të Sigurimit të Shtetit: "Sherlokholmsët" si model operacional i aparatit represiv " **Selami Zalli**, Drejtor i Informacionit në AIDSSH, argumentoi se dosjet e personelit dëshmojnë se Sigurimi i Shtetit ndërtoi një sistem të mirëorganizuar klasifikimi, rekrutimi dhe administrimi të bashkëpunëtorëve, ku çdo kategori kishte rol të përcaktuar në funksionimin e aparatit represiv.

Sipas studimit, bashkëpunëtorët zyrtarë – oficerë, nënoficerë, drejtues degësh, shefa strukturash dhe punonjës të Sigurimit – përbënin hallkën më të rëndësishme të mekanizmit të kontrollit politik. Krahas tyre funksiononin kategori të tjera, si rezidentët, strehuesit, patriotët, informatorët, agjentët dhe personat e rekrutuar me materiale shtrënguese, duke krijuar një rrjet të gjerë mbikëqyrjeje mbi shoqërinë.

Autori argumentoi se dokumentet arkivore tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e personelit të Sigurimit kishte nivel të ulët arsimor, ndërsa mes tyre identifikohen edhe persona me të kaluar kriminale apo me sjellje të rënda morale, të gatshëm të denonconin edhe familjarët e tyre. Sipas tij, këto karakteristika nuk ishin rastësore, por pasqyronin profilin që aparati represiv kërkonte për të garantuar bindjen dhe zbatimin e urdhrave.

Studimi thekson gjithashtu se vetë strukturat e Sigurimit i nënshtroheshin goditjeve dhe spastrimeve periodike, duke përfshirë edhe drejtues të lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Sipas autorit, analiza e tipologjisë së bashkëpunëtorëve ndihmon në kuptimin e mekanizmave njerëzorë mbi të cilët u mbështet funksionimi i aparatit represiv gjatë diktaturës komuniste.

Studimi: Dokumentet arkivore zbulojnë se rrjeti i bashkëpunëtorëve administrohej sipas një mekanizmi të standardizuar kontrolli

Një studim i prezantuar nga **Msc. Mirela Murrizi (AIDSSH)** tregon se rrjeti i bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit nuk funksiononte në mënyrë spontane, por mbi procedura të mirëpërcaktuara që rregullonin çdo fazë të marrëdhënies me organin operativ.

I mbështetur në analizën e katër dosjeve të plota arkivore të bashkëpunëtorëve, studimi rindërton të gjithë ciklin e administrimit, nga planifikimi dhe rekrutimi deri te vlerësimi i veprimtarisë dhe përfundimi i bashkëpunimit.

Dokumentet tregojnë se rekrutimi realizohej si mbi baza të deklaruara vullnetare, ashtu edhe përmes formave të ndryshme të shtrëngimit, ndërsa bashkëpunëtorët monitoroheshin vazhdimisht përmes dosjeve personale, raporteve informative, karakteristikave operative dhe një sistemi shpërblimesh e vlerësimi.

Sipas studimit, efektiviteti i bashkëpunëtorëve matej me cilësinë e informacionit, ruajtjen e konspiracionit dhe rezultatet konkrete në procesin e përpunimit operativ, duke dëshmuar se rrjeti informativ ishte një strukturë e organizuar dhe e administruar sipas metodave të standardizuara të kontrollit.

Bashkëpunimi me Sigurimin nuk ishte gjithmonë zgjedhje, por produkt i frikës dhe mbijetesës

Në kumtesën "**Aspekte psiko-sociale të profileve të bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit në Shqipëri**", Miranda Imami dhe Elona Baçi (AIDSSH) sollën në qendër të analizës dimensionin njerëzor të bashkëpunimit me aparatit represiv komunist, duke u fokusuar te mekanizmat psikologjikë dhe shoqërorë që ndikuan në rekrutimin e bashkëpunëtorëve.

Duke u mbështetur në dokumente arkivore dhe në analizën e mënyrës së organizimit të Sigurimit të Shtetit, studiueset argumentuan se rrjeti informativ nuk ishte një strukturë spontane, por pjesë e një sistemi të centralizuar, të ndërtuar për të depërtuar në çdo sferë të jetës shoqërore – nga ushtria, ekonomia dhe arsimi, te kultura, komunitetet fetare, burgjet dhe kufiri.

Studimi trajtoi pyetjen se cilët faktorë i shtynin individët të pranonin bashkëpunimin me Sigurimin e Shtetit. Sipas autoreve, ky bashkëpunim nuk ishte gjithmonë rezultat i një zgjedhjeje të lirë apo bindjeje ideologjike. Në shumë raste ai ishte pasojë e frikës, izolimit, shantazhit, presionit psikologjik, cenueshmërisë personale dhe instinktit të mbijetesës në një regjim që e kishte shndërruar rekrutimin në një mekanizëm të mirëorganizuar kontrolli dhe nënshttrimi.

Punimi evidentoi se Sigurimi nuk synonte vetëm mbledhjen e informacionit, por krijimin e një klime të përhershme pasigurie dhe mosbesimi, ku individët ndiheshin vazhdimisht të survejuar dhe të ekspozuar ndaj presionit. Në këtë mënyrë, bashkëpunimi me aparatën e Sigurimit u bë pjesë e arkitekturës së kontrollit shoqëror, duke ndikuar jo vetëm te personat e rekrutuar, por edhe te marrëdhëniet mes njerëzve dhe te besimi brenda komuniteteve.

Sigurimi nuk e zbuti veprimtarinë e tij as në prag të rrëzimit të regjimit, rasti I dosjes së Mit'Hat Havarit

Në kumtesën "**Analiza e profilit social dhe funksional të bashkëpunëtorëve në dosjen e Mit'Hat Havarit: Tipologji, rekrutim dhe efektivitet raportimi**", Msc. Oralda Muça dhe Msc. Anxhela Dervishi (AIDSSH) paraqitën gjetje të mbështetura në analizën e dokumenteve arkivore të dosjes së përpunimit nr. 4171 të Mit'Hat Havarit, e cila mbulon periudhën 1982–1990. Dokumentet dëshmojnë se, edhe në vitet e fundit të regjimit komunist, Sigurimi i Shtetit vazhdonte të përdorte të njëjtët mekanizma të survejimit, përpunimit operativ dhe kontrollit politik.

Sipas studimit, dosja eidenton se Mit'Hat Havari kaloi disa herë nga përpunimi aktiv 2A në 2B dhe anasjelltas, ndërsa monitorimi nuk u ndërpre asnjëherë. Madje, në vitin 1990, kur sistemi komunist po përjetonte krizën e tij përfundimtare, ai u rikthye sërish në përpunim aktiv 2A, duke dëshmuar se aparati represiv vazhdonte të funksiononte me të njëjtën logjikë deri në prag të ndryshimeve demokratike.

Dokumentacioni arkivor zbulon gjithashtu se ndjekja e tij mbështetej në një rrjet të organizuar bashkëpunëtorësh me profile të ndryshme shoqërore dhe profesionale. Dhjetë bashkëpunëtorë ose kandidatë për bashkëpunim dhe të paktën 31 raporte informative dëshmojnë se kontrolli nuk mbështetej në veprime të rastësishme, por në një sistem të vazhdueshëm mbikëqyrjeje dhe verifikimi të informacionit. Sipas autoreve, vetë struktura e këtij rrjeti krijonte një klimë të përhershme pasigurie dhe mosbesimi, duke e shtrirë kontrollin e Sigurimit përtej institucioneve shtetërore dhe në jetën e përditshme të individit.

Si e vëzhgonte Sigurimi rezidenturën e shërbimit sekret polak në Tiranë

Në kumtesën "**Rezidentura e shërbimit sekret polak në Tiranë dhe kundërzbulimi i Sigurimit**", historiani polak Witold Bagieński, studiues pranë Arkivit të Institutit të Kujtesës Kombëtare në Varshavë, analizoi marrëdhëniet mes shërbimit sekret të Polonisë komuniste dhe Sigurimit të Shtetit shqiptar gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë.

Studimi eidenton se kontaktet zyrtare mes organeve të sigurisë të dy vendeve nisën në vitin 1955, në kuadër të bashkëpunimit të vendeve të bllokut lindor, por u zbehën gradualisht me përkeqësimin e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik. Në këtë kontekst, në vitin

1966, shërbimi i inteligjencës së jashtme polake ngriti në Tiranë një rezidenturë me emrin e koduar "**Piaski**" (**Rërat**), e cila vepronte nën mbulesën diplomatike të Ambasadës Polake.

Sipas Bagieńskit, rezidentura kishte si objektiv mbledhjen e informacionit mbi zhvillimet politike në Shqipëri, orientimin e politikës së jashtme të regjimit komunist, si dhe gjurmimin e disidentit komunist polak **Kazimierz Mijal**, i cili kishte gjetur mbështetje në Shqipëri pas prishjes së marrëdhënieve të tij me autoritetet polake.

Studimi tregon se veprimtaria e oficerëve polakë zhvillohej nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të kundërzbulimit të Sigurimit të Shtetit. Dokumentet dëshmojnë se Sigurimi ushtronte survejim intensiv ndaj diplomatëve dhe oficerëve të inteligjencës polake, duke monitoruar lëvizjet, kontaktet dhe aktivitetin e tyre në territorin shqiptar. Sipas autorit, ky rast ilustron klimën e mosbesimit që karakterizonte marrëdhëniet edhe mes vendeve të kampit socialist, ku shërbimet sekrete monitoronin njëra-tjetrën pavarësisht përkatësisë në të njëjtin bllok politik.

Në përfundim, Bagieński argumentoi se analiza e dokumenteve arkivore ndihmon në kuptimin e dinamikës së bashkëpunimit dhe rivalitetit mes shërbimeve sekrete të vendeve komuniste, duke nxjerrë në pah rolin qendror të Sigurimit të Shtetit në kontrollin e aktivitetit të shërbimeve të huaja në Shqipëri gjatë Luftës së Ftohtë.

Nga studim tek harta digjitale mbi represionin në Tiranë

Duke u mbështetur në analizën e 126 dosjeve ORV dhe 147 librave të evidencës operative me mbi 12 300 regjistrime, studimi për Sigurimin në Tiranë kaloi nga kërkimi dokumentar në vizualizim hapësinor, duke rindërtuar rrjetin e survejimit dhe shpërndarjen territoriale të objekteve të kontrollit.

Rezultati është një hartë interaktive digjitale e Tiranës, ku lokalizohen objektet e survejimit, burgjet, kampet e punës së detyruar, vendet e internimit dhe vendvarrimet e pushënuara. Kjo hartë e kthen arkivin në një instrument publik të kujtesës, kërkimit shkencor dhe edukimit demokratik. Studimi i udhëhequr nga Dr. Gentiana Sula, dhe prezantuar nga Nevila Turdiun ai shërbeu si bazë për një hap të ri: transformimin e të dhënave arkivore në një hartë të aksesueshme për publikun.

Gjykata Speciale, instrumenti kryesor i terrorit politik komunist

Sesioni i tretë i konferencës, kushtuar aspekteve politike, ligjore dhe arkivore, u hap me një studim të Msc. Jonel Hibo (AIDSSH), i cili solli në vëmendje një nga përpjekjet më pak të njohura të regjimit komunist për të institucionalizuar veprimtarinë e Sigurimit të Shtetit.

Duke analizuar Gjykatën Speciale për gjykimin e krimeve të kryera nga punonjësit e Sigurimit të Shtetit dhe Kolegjin Special të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të krijuara në vitet 1949–

1956, studimi arrin në përfundimin se këto përbënin rastet e vetme kur regjimi tentoi t'i jepte një bazë formale ligjore aparatit represiv.

Punimet vazhdojnë më 30 qershor me sesione kushtuar pasojave psikologjike, sociale dhe ndërbreznore të përndjekjes politike, marrëdhënieve ndërmjet fesë dhe represionit komunist, drejtësisë tranzicionale, kujtesës historike dhe ndikimit afatgjatë të diktaturës mbi individin, familjen dhe shoqërinë shqiptare.

Në përfundim të konferencës pritet të miratohet deklarata për institucionalizimin e saj si një simpozium shkencor ndërkombëtar i përvitshëm, duke synuar ta kthejë studimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit në një platformë të qëndrueshme kërkimore dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.

Trauma e diktaturës nuk përfundoi me rënien e regjimit, por vazhdon të transmetohet ndër breza

Ditën e dytë të Konferencës Ndërkombëtare Shkencore "Aspekte të përndjekjes politike të ish-Sigurimit të Shtetit Shqiptar (1944–1991)", vëmendja e studiuesve u përqendrua te pasojat afatgjata të diktaturës, duke analizuar ndikimin psikologjik, shoqëror dhe njerëzor të përndjekjes politike.

Astrit Jegeni, ish i dënuar politik, gjate fjalës së tij i argumentoi përmes përvojës personale se trauma e diktaturës nuk përfundonte me dënimin apo me lirimin e viktimave, por vazhdon të transmetohet edhe sot në familje dhe në shoqëri.

Përmes historive konkrete të viktimave, studiuesi solli rastin e Petro Jorgji Licës, një i internuar i paralizuar, i cili edhe në atë gjendje mbahej nën kontroll gjatë apelit, duke dëshmuar se aparati represiv ushtronte mbikëqyrje edhe ndaj njerëzve plotësisht të pafuqishëm.

Sipas studimit përshkrues së tij, këto përvoja nuk përfaqësojnë vetëm episode të së kaluarës, por shpjegojnë mënyrën se si trauma, frika dhe pasojat e përndjekjes politike vazhdojnë të ndikojnë në kujtesën familjare dhe në jetën shoqërore edhe dekada pas rënies së regjimit **komunist**.

Frika e diktaturës vazhdon të trashëgohet te brezat që nuk e kanë jetuar atë

Një studim i prezantuar nga dy kërkueset shkencore **Msc.Kadrije Tabaku dhe MSc. Evita Karanxha** tregon se pasojat psikologjike të diktaturës vazhdojnë të ndikojnë edhe te brezat e lindur pas rënies së regjimit komunist.

Përmes dëshmive të të rinjve të moshës 20–25 vjeç, studiueset evidentojnë se frika e trashëguar nga prindërit për të folur hapur dhe për t'u besuar të tjerëve vazhdon të ndikojë në marrëdhëniet familjare dhe shoqërore.

Sipas studimit, rrëfimet e brezit që përjetoi diktaturën kanë transmetuar te fëmijët ndjenjën e pasigurisë, mungesën e besimit dhe prirjen për të ruajtur distancë emocionale, duke dëshmuar se mekanizmat e kontrollit të së kaluarës vijoje në lënë gjurmë në jetën e brezave të rinj.

Sigurimi përdori bashkëpunimin e detyruar për të shkatërruar besimin mes të përndjekurve politikë

Një nga dëshmitë më prekëse të ditës së dytë të konferencës u soll nga Nestor Topençarov, ish-i burgosur politik, i cili rrëfeu se Sigurimi i Shtetit përdorte bashkëpunimin e detyruar si një mekanizëm për të përçarë vetë shtresën e të përndjekurve politikë.

Duke iu referuar dokumenteve të dosjes së familjes së tij, ai tregoi se 23 bashkëpunëtorë ishin angazhuar në ndjekjen e familjes, ndërsa zbulimi se 4 nga 8 ish-bashkëpunëtorët e tij në Spaç kishin bashkëpunuar me Sigurimin dëshmon se regjimi synonte të shkatërronte besimin dhe solidaritetin mes të burgosurve politikë.

Megjithatë, Topençarov theksoi se shumë prej bashkëpunëtorëve vepruan nën shantazh dhe presion ekstrem, duke bërë thirrje për zbardhjen e së vërtetës, pendesën dhe faljen, pa cenuar përgjegjësinë historike për krimet e kryera.

Manipulimi i kujtesës historike mbetet një nga rreziqet më të mëdha për demokracinë

Ndër pjesëmarrësit ndërkombëtarë të konferencës ishte gazetari dhe studiuesi italian **Dr. Antonio Caiazza**, gazetar i RAI-t dhe një nga njohësit më të mirë të historisë bashkëkohore të Shqipërisë në Itali.

Prej më shumë se 30 vitesh ai ka ndjekur zhvillimet në Ballkan, duke raportuar për ngjarje kyçe si kriza shqiptare e vitit 1997 dhe lufta e Kosovës. Autor i disa librave kushtuar Shqipërisë, Caiazza ka hulumtuar gjerësisht në arkivat italiane dhe shqiptare, ndërsa botimi i tij më i fundit sjell dokumente të panjohura mbi marrëdhëniet italo-shqiptare gjatë periudhës komuniste.

Në konferencë ai paraqiti kumtesën "Kujtesa në kohën e urrejtjes", ku trajtoi marrëdhënien mes kujtesës historike, etikës së kërkimit shkencor dhe mbrojtjes së demokracisë. Sipas tij, shoqëritë nuk përcaktohen vetëm nga e kaluara që kanë jetuar, por edhe nga mënyra se si zgjedhin ta kujtojnë dhe ta interpretojnë atë. Për këtë arsye, historia duhet të ndërtohet mbi një lexim kritik dhe të plotë të dokumenteve arkivore, duke shmangur përdorimin selektiv të burimeve që prodhon kujtesë të deformuar dhe ushqen ndarjet shoqërore.

Një pjesë e rëndësishme e kumtesës iu kushtua analizës së mekanizmave të regjimeve totalitare. Duke sjellë shembuj nga fashizmi italian, nazizmi, stalinizmi dhe regjimi komunist i Enver Hoxhës, Caiazza argumentoi se autoritarizmi nuk shfaqet papritur, por ndërtohet gradualisht përmes dobësimit të institucioneve demokratike, kufizimit të lirive dhe manipulimit të kujtesës kolektive. Duke cituar Umberto Eco, ai kujtoi se "liria dhe çlirimi janë një detyrë që nuk mbaron kurrë", duke theksuar se mbrojtja e demokracisë kërkon vigjilencë të vazhdueshme.

Për ta ilustruar këtë ide, studiuesi e krahasoi demokracinë me një digë që përballon vazhdimisht presionin e ujit. Ashtu si një digë kërkon mirëmbajtje të përhershme për të mos u shembur, edhe demokracia ka nevojë për institucione të forta, respektim të ligjit dhe qytetarë të angazhuar për të mbrojtur liritë dhe të drejtat themelore. Në të kundërt, paralajmëroi ai, pushteti tenton të zgjerohet gradualisht përtej kufijve të vendosur nga ligji.

Caiazza ndaloi edhe te sfidat që sjell epoka digjitale për të vërtetën historike. Ai kujtoi se në regjimet totalitare manipuloheshin fotografitë për të fshirë nga historia njerëzit që kishin rënë në disfavor të pushtetit. Sot, tha ai, zhvillimi i inteligjencës artificiale dhe teknologjive të reja e bën edhe më të lehtë krijimin e imazheve dhe narrativave të rreme, duke e bërë verifikimin kritik të dokumenteve dhe burimeve historike më të domosdoshëm se kurrë.

Lufta e klasave nisi që në djep: Fëmijët, viktimat e pafajshme të diktaturës - rasti i Gani Sulkës dhe Marjana Rondos

Në kumtesën "Fëmijët e të ashtuquajturve 'armiq të partisë' në vështrimin e ish-Sigurimit të Shtetit dhe pasojat psiko-sociale: rasti i Gani Sulkës dhe Marjana Rondos", **Najada Pendavinji, studiuese pranë Fondacionit Kujto.al**, argumentoi se një nga padrejtësitë më të mëdha të regjimit komunist u ushtrua ndaj foshnjave dhe fëmijëve, të cilët u shpallën fajtorë vetëm për shkak të biografisë së familjes. Sipas saj, lufta e klasave nuk ndëshkonte vetëm kundërshtarët e regjimit, por vazhdonte sistematikisht edhe mbi fëmijët e tyre, duke e kthyer fëmijërinë në një formë dënimi kolektiv.

Përmes historive të Gani Sulkës dhe Marjana Rondos, studimi dëshmoi se mijëra fëmijë u rritën në burgje dhe kampe internimi, në kushte çnjerëzore, të privuar nga liria, arsimi dhe një jetë normale. Ata u përballën me urinë, punën e detyruar, diskriminimin dhe përjashtimin shoqëror, ndërsa stigma e "fëmijës së armikut" i ndoqi në çdo hap të jetës. Autorja theksoi se shumë prej tyre u detyruan të punonin në tharjen e kënetave, hapjen e kanaleve, ndërtimin e fabrikave dhe në miniera, duke u bërë viktimat e një sistemi që ndëshkonte brezat për "faje" të imagjinuara të prindërve.

Sipas studimit, propaganda komuniste pretendonte se të gjithë fëmijët ishin "fëmijë të nënës Shqipëri", por në realitet fëmijët e familjeve të përndjekura mbetën jashtë kësaj barazie të shpallur, të dënuar të jetonin nën survejim, frikë dhe diskriminim. Pendavinji argumentoi se pasojat psikologjike dhe shoqërore të kësaj politike nuk përfunduan me rrëzimin e regjimit, por vazhduan të shoqëronin jetën e tyre edhe në demokraci, duke mbetur pjesë e kujtesës kolektive të shoqërisë shqiptare.

Kisha Orthodhokse nën kontroll përmes përndjekjes së Kryepiskopit Kristofor Kisi

Në kumtesën "Përndjekja e Kristofor Kisit, Kryepiskopit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë nën regjimin komunist", **Dr. Thoma Shkira, pedagog në Kolegjin Universitar "Logos"**, paraqiti dokumente arkivore dhe fakte historike që hedhin dritë mbi ndërhyrjen e regjimit komunist në drejtimin e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Studimi argumenton se largimi i detyruar i Kryepiskopit Kristofor Kisi nga drejtimi i Kishës më 25 gusht 1949 nuk ishte një zhvillim i brendshëm kishtar, por pjesë e një strategjie të mirëorganizuar të regjimit për të nënshtuar institucionet fetare ndaj kontrollit politik. Pas shkarkimit, Kryepiskopi u largua nga çdo veprimtari kishtar dhe u mbajt në izolim në Kishën e Shën Prokopit në Tiranë deri në vdekjen e tij, në rrethana të dyshimta, më 17 qershor 1958.

Duke u mbështetur në dokumente të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Arkivit Qendror Shtetëror, shtypit të kohës dhe dëshmi të ndryshme, Shkira evidentoi se përndjekja e Kristofor Kisit shënoi depërtimin e strukturave të regjimit komunist në jetën e brendshme të Kishës Orthodhokse. Sipas studimit, kontrolli i ushtruar mbi drejtimin kishtar u shndërrua në një instrument për nënshtimin e institucionit fetar, proces që kulmoi me goditjen e organizuar të fesë dhe mbylljen e institucioneve fetare në vitin 1967.

Punimi trajtoi gjithashtu edhe përndjekjen e figurave të tjera të larta të Kishës Orthodhokse, si Visarion Xhuvani dhe Irine Banushi, duke treguar se goditja ndaj klerit ortodoks nuk ishte e

izoluar, por pjesë e një politike sistematike të shtetit komunist për të eliminuar autonominë e komuniteteve fetare dhe për t'i vendosur ato nën mbikëqyrjen e aparatit të Sigurimit të Shtetit.

Sigurimi e trajtonte besimin fetar si kërcënim për pushtetin, rasti i Doms

Në kumtesën "Përndjekja e Besimit Fetar gjatë Diktaturës Komuniste: Rasti i Dom Shtjefën Kurtit", **MSc. Gerhard Mema**, studiues pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, paraqiti dokumente arkivore që hedhin dritë mbi mekanizmat e kontrollit dhe represionit të ushtruar ndaj klerit katolik nga Sigurimi i Shtetit.

Duke marrë në analizë rastin e Dom Shtjefën Kurtit, prift katolik nga Kosova dhe një prej figurave më të njohura të qëndresës fetare në Shqipëri, studimi tregoi se regjimi komunist e konsideronte ushtrimin e besimit fetar si një veprimtari armiqësorë dhe një kërcënim për pushtetin. Përmes dokumenteve arkivore evidentohet se edhe veprimet më të zakonshme fetare mund të interpretoheshin si "veprimtari kundër shtetit", duke u përdorur si bazë për ndjekje penale, izolim dhe dënim.

Sipas studimit, Sigurimi i Shtetit ngriti një rrjet të gjerë kontrolli mbi Dom Shtjefën Kurtin, duke përdorur bashkëpunëtorë, informatorë dhe agjentë për të mbikëqyrur çdo lëvizje, takim dhe komunikim të tij. Raportet operative, të hartuar mbi bazën e survejimit dhe infiltrimit, shërbenin jo vetëm për të dokumentuar aktivitetin e priftit, por edhe për të justifikuar masat represive të ndërmarra ndaj tij.

Gerhard Mema argumentoi se rasti i Dom Shtjefën Kurtit dëshmon mënyrën se si Sigurimi i Shtetit përdorte metoda të mirëorganizuara, si infiltrimi, spiunimi, presioni psikologjik dhe izolimi, për të krijuar një klimë frike dhe për të dekurajuar ushtrimin e besimit fetar në tërësi. Sipas tij, dokumentacioni arkivor nuk pasqyron vetëm faktet e ndjekjes së një kleriku, por edhe mentalitetin e një sistemi represiv që synonte të kontrollonte ndërgjegjen dhe lirinë e besimit.

Në përfundim, studiuesi theksoi se rasti i Dom Shtjefën Kurtit mbetet një dëshmi e rëndësishme e përndjekjes së organizuar ndaj komuniteteve fetare gjatë diktaturës komuniste dhe nënvizoi rëndësinë e kërkimit arkivor në ruajtjen e kujtesës historike dhe edukimin e brezave të rinj mbi pasojat e mohimit të lirisë së besimit.

Të shpallur "kulakë", por të detyruar të ndërtonin tunelet e regjimit komunist

Në kumtesën "Epoka e errët e periudhës komuniste në Baldushk – Tiranë: një qasje analitike mbi kulakët dhe krijimin e tuneleve", **Msc. Erta Beti** paraqiti një analizë mbi pasojat e luftës së klasave në zonën e Baldushkut, duke u ndalur te fati i familjeve të shpallura "kulakë" dhe kontradiktat e sistemit komunist.

Studimi argumenton se lufta kundër kulakëve ishte një nga mekanizmat kryesorë të kontrollit politik dhe shoqëror të regjimit, përmes të cilit mijëra qytetarë u shpronësuan, u internuan, u privuan nga të drejtat themelore dhe u stigmatizuan si "armiqtë e klasës". Përmes dokumenteve arkivore dhe dëshmive të ish-të përndjekurve politikë, autorët evidentuan se dhuna nuk synonte vetëm konfiskimin e pasurisë, por edhe zhdukjen e identitetit dhe historisë së këtyre familjeve.

Një nga paradokset më domethënëse që evidenton studimi është fakti se shumë prej njerëzve të shpallur "kulakë" dhe të përndjekurve politikë u detyruan të punonin në ndërtimin e tuneleve ushtarake, një prej projekteve më të mëdha të regjimit komunist. Të privuar nga liria dhe të drejtat e tyre, ata u angazhuan në punë të detyruar për ndërtimin e infrastrukturës mbrojtëse të shtetit që njëkohësisht i kishte shpallur armiq.

Punimi sjell në vëmendje edhe dëshmitë e ish-të burgosurve politikë nga Baldushku, të cilat pasqyrojnë klimën e frikës, dhunës dhe represionit që karakterizoi jetën në zonë gjatë diktaturës. Sipas autoreve, këto rrëfime përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kujtesës kolektive, duke ndihmuar në kuptimin e pasojave afatgjata që politika e luftës së klasave la mbi individin, familjen dhe komunitetin.

Në përfundim, studimi thekson se rikthimi te dokumentet arkivore dhe dëshmitë e të mbijetuarve është thelbësor për të kuptuar mekanizmat e represionit komunist dhe për të ruajtur kujtesën historike, në mënyrë që padrejtësi të tilla të mos përsëriten më.

Konferenca u përmyll me një deklaratë të Kryetares së Autoritetit, Dr. Gentiana Mara Sula, e cila theksoi se kërkimi mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit ka hyrë në një fazë të re, më të thelluar dhe ndërdisiplinore. Sipas saj, studimi i mekanizmave të represionit nuk është vetëm një proces historik dhe arkivor, por edhe një angazhim etik për të kuptuar përgjegjësinë, pasojat e dhunës shtetërore dhe ndikimin e saj ndër breza. Ajo vlerësoi si të domosdoshëm vazhdimin e konferencave shkencore periodike dhe organizimin e simpoziumeve tematike, në mënyrë që kërkimi mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet studiuesve, universiteteve dhe institucioneve. Gjithashtu, theksoi rëndësinë e publikimit të dokumenteve të reja në mediatekën e AIDSSH dhe të botimeve shkencore që do ta pasurojnë më tej studimin e kësaj periudhe. Në përmyllje, Dr. Sula ritheksoi se dokumentet e ish-Sigurimit janë themel për ndërtimin e një kujtese të bazuar në të vërtetën, pasi "vetëm kështu kujtesa bëhet dije, dija bëhet përgjegjësi dhe përgjegjësia garanci që e shkuara të mos përsëritet."